Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut
Средно општинско училиште
Гимназија "Сами Фрашери"
Shkolla e mesme komunale
Gjimnazi "Sami Frashëri"
Бр.-Nr. 03-951/1
31.03. 2026 год.-viti
КУМАНОВО-KUMANOVË

KONKURS

për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme publike në vitin shkollor 2026/2027 në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në shkollat e mesme publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin shkollor 2026/2027, sipas planeve dhe programeve mësimore të caktuara do të regjistrohen numri i nxënësve si vijon:

SHKOLLA E MESME KOMUNALE „SAMI FRASHËRI" Kumanovë

Në vitin e parë do të regjistrohen 204 nxënës në 6 paralele me mësim në gjuhën shqipe sipas planeve dhe programeve mësimore si vijojnë:

Gjimnaz – 204 nxënës, 6 paralele, minimum 60 pikë shq 204 nx. 6 par.

II. KUSHTET E REGJISTRIMIT DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E NXËNËSVE

Regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme publike (në tekstin e mëtejmë: shkollat) për vitin shkollor 2026/2027 do të realizohet në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me Ligjin për Arsimin e Mesëm, Ligjin për Arsimin Profesional dhe Trajnim, Ligjin për Akademinë e Sportit, Ligjin për Gjimnazin Matematikë – Informatikë dhe me këtë Konkurs.

Kushtet për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë janë:

- të ketë të përfunduar arsimin fillor;

- të mos jetë mbi moshën 17 vjeç, ndërsa nxënësi me nevoja të veçanta arsimore të mos jetë më i vjetër se 25 vjeç - të përcaktohen në njërën nga planet dhe programet e mëposhtme të llojit të arsimit: a) arsimi i mesëm;

b) arsimi profesional dhe trajnim;

c) arsimi i mesëm artistik;

- të plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë Konkurs.

Kriteret për përzgjedhjen e nxënësve janë:

- suksesi mesatar i nxënësit nga klasa e VI deri në të IX;

- suksesi mesatar i nxënësit të arritur në 4 lëndë (gjuhë amtare, gjuhë angleze dhe dy lëndë të rëndësishme për sektorin);

-diploma për vendet e fituara (I, II dhe III) nga garat ndërkombëtare, si dhe marrja e vendit të parë në gara shtetërore të organizuar nga shoqata të akredituara të mësimdhënësve për realizimin e garave në arsimin fillor nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës

- vlera mesatare e pikëve të fituara për sjelljen nga klasa VI deri në klasën IX.

Për nxënësit të cilët konkurrojnë për regjistrim në Akademinë e Sporteve, krahas kritereve të lartëshënuara për përzgjedhje, vlerësohen edhe aftësitë sportive në përputhje me Ligjin për Akademinë e Sporteve.

Për nxënësit të cilët konkurrojnë për regjistrim në Gjimnazin Matematikë-Informatikë, krahas kritereve të lartëshënunara të përzgjedhjes, vlerësohen edhe pikët e fituara nga provimi pranues në Matematikë dhe Fizikë në përputhje me Ligjin për Gjimnazin Matematikë-Informatikë.

Në arsimin e mesëm për art mund të regjistrohen edhe nxënësit e talentuar, të cilët nuk kanë përfunduar arsimin fillor, mirëpo pas pëlqimit paraprak me shkrim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në bazë të propozimit nga shkolla, me detyrim që paralelisht të përfundojë arsimin fillor.

Nxënësit nga komuniteti etnik rom mund të regjistrohen në shkollë të mesme publike të caktuar, nëse kanë deri në 10% më pak pikë, sesa numri i pikëve të parapara në Konkurs për planet dhe programet mësimore përkatëse dhe nëse plotësojnë kriteret shtesë për testin e njohurive dhe aftësive në shkollën përkatëse.
Zbatimi i kësaj mase afirmative bëhet pas përfundimit të renditjes dhe nuk ndikon në statusin e kandidatëve që
tashmë janë renditur dhe që plotësojnë numrin minimal të pikëve të parashikuara.
Në shkollat ku konkurojnë numër më i madh i nxënësve që i plotësojnë kushtet nga numri i planifikuar i paraparë në këtë konkurs, për ata që përmbushin kushtet e parashikuara, organizohet test kualifikues nga materiali mësimor nga klasa e tetë - nëntë në lëndët mësimore vijuese edhe atë: -për arsimin e mesëm gjimnaz- gjuhë amtare dhe matematikë; -për sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale - biologji dhe kimi - për sektorët e tjerë - gjuhë amtare dhe matematikë.
Në arsimin e mesëm për art (muzikë, balet dhe art), në gjimnazin për sport, akademia sportive, shkollat përcaktojnë kritere shtesë.
Për suksesin mesatar nga klasa VI deri në klasën IX nxënësi mund të marrë më së shumti 50 pikë (suksesi i përgjithshëm nga klasa e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë, mblidhet, pastaj pjesëtohet me katër dhe i njëjti numër shumëzohet m. koeficientin 10).
Për suksesin mesatar të arritur nga katër lëndët e propozuara (dy lëndë mësimore të detyrueshme për të gjitha llojet e arsimit dhe dy lëndë të rëndësishme për profesionin), nxënësi mund të marrë më së shumti 20 pikë (5 pikë për secilën lëndë).
Për vendi e parë të fituar në gara shtetërore të organizuar nga shoqata e akreditуar e mësimdhënësve për realizimin e garave në arsimin fillor nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, nxënësi mund të marrë 3 pikë:
Për vendit të parë, të dytë ose të tretë të fituar, përkatësisht medaljes së artë, të argjendtë, ose të bronztë në gara ndërkombëtare, nxënësi mund të marrë përkatësisht 5, 4, ose 3 pikë.
Për vlerën mesatare të pikëve të sjelljes nga klasa VI deri në IX, nxënësi mund të marrë maksimumi 5 pikë. (Sjellja shembullore vlerësohet me 5 pikë, sjellja e mirë vlerësohet me 3 pikë dhe sjellja e pakënaqshme vlerësohet me 0 pikë. Vlera mesatare është shuma e pikëve për sjelljen në klasën e gjashtë, të shtatë, të tetë dhe të nëntë pjesëtuar me 4).
Numri i përcaktuar i pikëve minimale për konkurimin e parë është pjesë përbërëse e këtij konkursi.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Pas regjistrimit të suksesshëm elektronik, nxënësit në shkollën e mesme publike të përzgjedhur dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:
- fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitja e nxënësve gjenerohet duke printuar fletëparaqitjen elektronike përmes sistemit të shërbimeve elektronike);
- certifikatat origjinale nga klasa VI deri në IX;
- diploma nga vendet e fituara (I, II dhe III) nga garat ndërkombëtare dhe/ose vendin e parë të fituar në gara shtetërore;
- certifikata nga libri amë i të lindurve (pavarësisht nga data e lëshimit).
- Vlerësim për aftësi të kufizuara nga sistemi i vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Për regjistrim në Akademinë e Sportit nxënësit dorëzojnë edhe vërtetim për aftësitë, shkathtësitë sportive, për sportin për të cilin nxënësi është i kontrolluar.
Për regjistrim në Gjimnazin Matematikë - Informatikë, nxënësit dorëzojnë edhe vërtetim për dhënien e provimit pranues me numrin e pikëve të fituara në matematikë dhe fizikë.
Për regjistrim në programin për maturë ndërkombëtare në Shkollën e Mesme të Qytetit të Shkupit Gjimnazi „Josip Broz Tito" - Shkup, dokumentet e nevojshme dhe të gjitha informatat tjera të nevojshme do të publikohen në tabelën për shpallje të shkollës.

IV. AFATET E KONKURSIT

Regjistrimi i nxënësve do të bëhet përmes aplikimit elektronik, përmes portalit https://euslugi.mon.gov.mk me paraqitje posaçme për nxënësit e shkollave të mesme përmes llogarive të tyre të përdoruesve të Schools.mk.

AFATI I QERSHORIT PËR REGJISTRIM :

***Paraqitja e parë elektronike** e nxënësve do të bëhet prej orës 00:00 të datës 12 qershor deri ora 23:59 të datës 15 qershor 2026.

-Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkolla është me datë 16 qershor 2026 nga ora 08:00 deri ora 19:00 dhe 17 qershor 2026 prej ora 08:00 deri në orën 15:00.

-Renditjen përfundimtare me rezultatet nga regjistrimi dhe vendet e lira, secila shkollë e publikon më 18 qershor 2026, më së voni deri në ora 12:00, në vend publik në shkollë dhe/ose në ueb faqen e shkollës.

-Testimi kualifikues do të organizohet në shkollat për arsim të mesëm më 22 qershor 2026, ndërsa renditja përfundimtare me rezultatet do të publikohet në ditën e njejtë në vendin publik në shkollë dhe/ose në ueb faqen e shkollës.

***Paraqitja e dytë elektronike** e nxënësve do të bëhet prej më 23 qershorë 2026 prej ora 00:00 deri në ora 23:59.

-Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkolla është më 24 qershorë 2026 prej ora 08.00 deri në ora 15:00

-Renditja e listës përfundimtare me rezultatet e regjistrimit dhe vendet e lira, secila shkollë do ta publikojë më 25 qershor 2026, më së voni deri në ora 12:00 në vend publik në shkollë dhe/ose në ueb faqen e shkollës

-Testimi kualifikues do të organizohet në shkollat e mesme në datën 29 qershor 2026, ndërsa listat përfundimtare të renditjes me rezultatet do të publikohen në ditën e njejtë në vend publik të shkollës.

AFATI I GUSHTIT PËR REGJISTRIM :

-Nxënësit të cilët dërgohen në riprovim korrigjues, provim vjetor, provime për përparim më të shpejtë, mund të regjistrohen në shkollat ku ka vende të lira dhe i plotësojnë kushtet e parapara nga Konkursi, pas afatit të qershorit me dy paraqitje.

- Paraqitja e nxënësve do të bëhet më datë 20 gusht 2026 prej ora 00:00 deri në orën 15:00 në mënyrë elektronike.

- Dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm në shkolla bëhet me datë 21 gusht 2026 prej ora 08:00 deri në orën 14:00.

- Lista përfundimtare me rezultatet e regjistrimit, secila shkollë do t'i publikojë në ditën e njejtë më së voni deri në ora 19:00.

Pas publikimit të listës ranguese përfundimtare me rezultatet e regjistrimit, nxënësit të cilët nuk janë regjistruar në shkollë, janë të obligjuar të tërheqin të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në shkollë brenda 24 orëve, ndërsa shkollat kanë detyrimin t'ua kthejnë të gjithë dokumentacionin nxënësve brenda 24 orëve.

Drejtori

Nagri Rexhepi